



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 10.5.2023

Nr: 482

Ora: 13:30

VENDIM

PËR

**VLERËSIMIN E RAPORTEVE TË MONITORUESVE TË FUSHATËS ZGJEDHORE PËR PERIUdhËN
E MONITORIMIT 2 MAJ DERI MË 8 MAJ 2023**

Sot më datë 10 Maj 2023, unë Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, në seancë publike pasi shqyrtova çështjen me:

OBJEKT: Vlerësimi i raportit të monitoruesve të fushatës për periudhën 2 maj deri më 8 maj 2023.

BAZA LIGJORE: Neni 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, e pika 2, neni 79, pika 3, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe udhëzimi nr. 6, datë 23.03.2021, i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve “Për përdorimin e materialeve propagandistike e edukuese dhe rregullat për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore”

Në përfundim të këtij shqyrtimi,

KONSTATOJ:

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka caktuar 120 (njëqind e njëzet) monitorues për fushatën zgjedhore të datës 14 maj 2023.

Monitoruesit e fushatës zgjedhore mbikëqyrin përmbushjen e detyrimeve nga subjektet zgjedhore në lidhje me financimin e fushatës dhe detyrimeve të tjera që përcaktohen në Kodin Zgjedhor. Monitorimi përfshin periudhën 4 muaj para datës së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve.

Për periudhën 2 Maj 2023 deri në 8 Maj 2023 janë përcjellë 222 (dyqind e njëzet e dy) raporte monitorimi në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

Data: 10.5.2023 Nr: 482
Ora: 13:30



“Për vlerësimin e raporteve të monitoruesve të fushatës zgjedhore për periudhën e monitorimit 2 maj deri më 8 maj 2023”

Nga vlerësimi që i është bërë gjetjeve në këto raporte për periudhën 2 Maj deri në 8 Maj 2023, rezulton se 6 prej tyre pasqyrojnë shkelje të Kodit Zgjedhor dhe udhëzimit nr. 6, datë 23.3.2021, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, “Për përdorimin e materialeve propagandistike e edukuese dhe rregullat për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore”.

Neni 79, pika 3, i Kodit Zgjedhor, përcakton se “...Të gjitha materialet propagandistike vizive që përdoren në fushatë duhet të shoqërohen me shënimin: “Prodhuar nën përgjegjësinë ligjore të...” (vijon emri i subjektit zgjedhor)”.

Neni 5, pika 1, i udhëzimit nr. 6, datë 23.3.2021 përcakton se, “Zyrat zgjedhore të subjekteve zgjedhore mund të hapen në një distancë jo më të vogël se 300 (treqind) metra nga vendndodhja e KZAZ-ve, QV-ve dhe VNV-ve.

Nga monitoruesit e fushatës zgjedhore janë konstatuar shkeljet si më poshtë vijon:

1. Për Subjektin zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”:

Janë hapur zyra zgjedhore në një distancë jo më të vogël se 300 (treqind) metra nga vendndodhja e KZAZ-ve, QV-ve dhe VNV-ve në:

- a. Bashkinë Tiranë, me vendndodhje Laprake pallati N tek blloku Gintash, në katin e parë ndodhet zyra e subjektit zgjedhor 123 m afër qendrës së votimit në shkollën "Aleks Buda". Raporti i monitoruesit me nr. unik 18489802, datë 5.5.2023.

Janë afishuar materiale propagandistike të cilat nuk përmbajnë shënimin “prodhuar në përgjegjësinë ligjore të” (vijon emri i subjektit zgjedhor) në:

- a. Bashkinë Gjirokastrë, billborder në bulevardin 18 Shtatori. Raporti i monitoruesit është gjeneruar nga sistemi me nr. unik 555105, datë 7.5.2023.
- b. Bashkia Elbasan, billbordera në të gjithë bulevardin qendror të qytetit. Raporti i monitoruesit me nr. unik 85478457, datë 8.5.2023.

2. Për subjektin zgjedhor Koalicionin “Bashkë Fitojmë”:

Janë afishuar materiale propagandistike të cilat nuk përmbajnë shënimin “prodhuar në përgjegjësinë ligjore të” (vijon emri i subjektit zgjedhor) në:

- a. Bashkinë Elbasan, billborder në rrugën Elbasan – Metalurgjik, rrethrotullimi i luleve me drejtim për Metalurgjik. Raporti i monitoruesit me nr. unik 97231374, datë 8.5.2023.

3. Për subjektin zgjedhor “Nisma Thurje”:

Janë afishuar materiale propagandistike të cilat nuk përmbajnë shënimin “prodhuar në përgjegjësinë ligjore të” (vijon emri i subjektit zgjedhor) në:

- a. Bashkinë Gjirokastrë, billboard në adresën bulevardi 18 Shtatori. Raporti i monitorimit me nr. unik 19266473, datë 7.5.2023.

4. Për subjektin zgjedhor “Partia Socialdemokrate”

Janë afishuar materiale propagandistike të cilat nuk përmbajnë shënimin “prodhuar në përgjegjësinë ligjore të” (vijon emri i subjektit zgjedhor) në:

- a. Bashkinë Tiranë, në kryqëzimin e rruga “Beqir Luga” dhe rruga “Ali Ndroqi”. Raporti i monitoruesit me nr. unik 84811236, datë 8.5.2023.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, e pika 2, neni 79, pika 3, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe udhëzimit nr. 6, datë 23.03.2021, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, “Për përdorimin e materialeve propagandistike e edukuese dhe rregullat për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore”,

V E N D O S:

1. Urdhërimin e Policisë Bashkiake dhe Policisë së Shtetit për mbylljen e menjëhershme të zyrës zgjedhore, në Bashkinë Tiranë, si vijon:
 - a) Të subjektit zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”, me vendndodhje Laprake pallati N tek blloku Gintash, në katin e parë ndodhet zyra e subjektit zgjedhor 123 m afër qendrës së votimit, në shkollën "Aleks Buda".
2. Urdhërimin e Policisë Bashkiake dhe Policisë së Shtetit për heqjen e menjëhershme të materialeve propagandistike, në Bashkitë Tiranë, Gjirokastrë dhe Elbasan, si vijon:
 - a) Billboarderat e subjektit zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”, në të gjithë bulevardin qendror, Bashkia Elbasan;
 - b) Billboarderin e subjektit zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”, në bulevardin 18 Shtatori, Bashkia Gjirokastrë;
 - c) Billboarderin e subjektit zgjedhor Koalicioni “Bashkë Fitojmë”, tek rrethrotullimi i luleve me drejtim për Metalurgjik, Bashkia Elbasan;

- ç) Billborderin e subjektit zgjedhor “Nisma Thurje”, në bulevardin 18 shtatori, Bashkia Gjirokastrë;
- d) Billborderin e subjektit zgjedhor “Partia Socialdemokrate”, në kryqëzimin e rrugës “Beqir Luga” me rrugë “Ali Ndroqi”, Bashkia Tiranë.
3. Përcjelljen e një raporti përmbledhës brenda datës 11 Maj 2023, ora 10:00, nga Policinë Bashkiake dhe Policia e Shtetit lidhur me zbatueshmërinë e vendimeve të Komisionerit, si për mbylljen e zyrave zgjedhore ashtu dhe për heqjen e materialeve propagandistike, përkatësisht:
- Vendimi nr. 424, datë 3.5.2023;
 - Vendimi nr. 452, datë 6.5.2023;
 - Vendimi nr. 453, datë 6.5.2023;
 - Vendimi nr. 455, datë 6.5.2023;
 - Vendimi nr. 456, datë 6.5.2023;
 - Vendimi nr. 461, datë 6.5.2023;
 - Vendimi nr. 472, datë 9.5.2023.
4. Ky vendim ju njoftohet subjekteve zgjedhore, Policisë së Shtetit si dhe Policive Bashkiake Tiranë, Elbasan dhe Gjirokastrë nëpërmjet postës elektronike.
5. Ngarkohen për zbatim të menjëhershëm të këtij vendimi Policia e Shtetit dhe Policinë Bashkiake Tiranë, Elbasan dhe Gjirokastrë.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
7. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI